



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK) - Divizioni i Ankesave – në përbërje të panelit shqyrtues të kryesuar nga Bashkim Paçarizi, anëtarë të panelit: Mevlyde Berisha dhe Flora Veliu njehe rit procesmbajtës, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjekti [REDACTED] ti

[REDACTED] kurse në Divizionin e Ankesave me datë 29/09/2022 me nr. protokolli 388/22, kundër vendimit mbi Njoftim-Rivlerësimet për Tatimin Shtesë, të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e ATK-së – Gjakovë, në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 03/L-222, „Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 23/09/2022, në prezencë të palëve: Zenel Musa – pronar i biznesit, Nik Jetishi-Kontabilist, Afrim Gjoka – inspektor i kontrollit, Fadil Shala-Udhëheqës Ekipi, nga zyra e avokatit të tatimpaguesit Valbona Sylja, mori këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet pjesërisht ankesa Nr.388/2022 e datës 09/09/2022 e subjektit tatimor [REDACTED], në mbështetje të nenit 132/4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurat Administrative, në lidhje me nenin 89, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.
- II. Ndryshohet Njoftim Rivlerësimi për Tatim në të Ardhura të Korporatave për vitin 2020 duke zvogëluar obligimin tatimor nga ai i vlerësuar nga kontrolli 51,001.07€ në 50,746.87€ (pa interes dhe ndëshkime) zvogëlimi i tatimit në fitim është 254.20€, si dhe Njoftim Rivlerësimin për Tatim mbi Vlerën e Shtuar periudha 03/2020 duke ulur TVSH-në për pagesë nga ai i vlerësuar nga kontrolli 508.35€ në 50.63€ (pa interes dhe ndëshkime), ulja e TVSH-së për pagës është 457.72€. Pjesa e mbetur pas ndryshimeve mbetet obligim për pagesë për tatimpaguesin.
- III. Procedura e ankesës nuk ndërprente obligimin e tatimpaguesit për pagesë të detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkime dhe interes) në përputhje me nenin 9, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-102 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Arsyetim

Tatimpaguesi ka dorëzuar ankesë përmes postes me date 06/09/2022 kurse në Divizionin e Ankesave më datë 09/09/2022, ndërsa Njoftim Rivlerësimet nga Kontrolli e ka pranuar më datë 15/08/2022, që për rrjedhojë ankesa është parashtruar në afatin ligjor prej 30 ditësh e përcaktuar me nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222 "Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore".

Kontrolli ka filluar me datë 30/05/2022 me ç' rast është kontaktuar pronari i biznesit për t'iu dorëzuar Formulari AU003 Dokument i kërkesës së informative, dhe njoftimi për fillimin e procedurës së kontrollit nga ATK me datë 30/05/2022 dhe me datë 31/05/2022 është realizuar edhe intervista fillestare në zyrat e ATK-se në Gjakovë.

Arsyeja e kontrollit është si rezultat i operimit apo ushtrimit të veprimtarisë me humbje, objekt i kontrollit sipas Raportit të Kontrollit ka qenë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar periudhat: 01/2019 – 12/2021 dhe CD/2019-2021.

Vlerësimi i kontrollit: Pas analizimit të blerjeve, librave të shitjes, faturat e blerjes dhe dudave doganor për periudhat kontrolluese është konstatuar se tatimpaguesi ka realizuar blerje nga bizneset vendore, blerje vendore, ku janë analizuar shpenzimet e derivateve sipas kilometrave dhe linjave të udhëtimit pasi që veprimtaria e biznesi është transporti i udhëtarëve në linjat Gjakove-Prishtine, Gjakovë-Peje, Gjakove-Prizren, Gjakove-Pejë, Pejë-Tiran-Pejë dhe anasjelltas dhe sipas kontrollit është tatimpaguesi i posedon librat e blerjes, librat e shitjes, shpenzimet dhe pasqyrat e të ardhurave personale vjetore, dhe sipas kontrollit është gjatë analizave për shpenzimet e derivateve nuk ka vërejt ndonjë parregullsi në shpenzimin e derivateve. Sipas raportit të kontrollit ku në periudhën 03/2020 kontrolli nuk ju ka pranua një fature në vlerë prej 2,452.88€ fatura e blerjes nga biznesi Molika Gas si dhe gjatë verifikimit të llogarive bankare në mungesë të argumentimit të deponimeve (mbajtjes së ditarit të arkës) tatimpaguesi është ngarkuar me qarkullim shtesë për periudhat kontrolluese.

Tatimpaguesi në ankesën e datës 09/09/2022 konteston raportin e kontrollit të lëshuar nga Administrata Tatimore Drejtoria Rajonale Gjakovës për shkak se konstatimi i bërë sipas Raportit të Kontrollit nuk është i bazuar në gjendjen reale faktike e si rrjedhojë raporti i kontrollit është përpiluar me aplikim të gabuar të dispozitave material, Pasi që depozitimet në bankomat me të cilat është deshtë me e paguar ratën mujore të kreditit këto pagesa janë bërë edhe nga huamarrjet të familjaret sepse nuk kemi muajt me i mbulua të gjitha shpenzimet, gjatë viteve 2020/2021 sa ishte edhe pandemia, kështu që kam dyfishim të raporteve të arkës fiskale sipas inspektorit, se autobusi ka udhëtuar me 10 persona për Prishtinë dhe anasjelltas ose për Tiranë me 8 persona, ngarkesen e shof si të tepërt për Biznesin Meti-Comerc .Ngarkesa e bërë për vitin 2019 shtesë për vlerën 8474.58€ dhe TVSH 1525.42€ sipas inspektorit këtu inspektorit e ka përfshi edhe shitjet e deklaruar njëherë sipas dorëzimit në banke. Ndërsa sipas planit të amortizimit është me datë 17.05.2019 deri 31.12.2019 vlera shtesë është 6100,03 dhe TVSH 1098,00 për vitin 2019.Ndërsa për vitin 2020 sipas datës 01/01/2020 deri me 31/12/2020 Sipas inspektorit 10940.68 dhe TVSH 1969.32 edhe në këtë vlerë i ka përfshi shitjet totale dhe Deponimet, që nga këto shitje janë dorëzua në banke. Ndërsa për vitin 2020 sipas planit të amortizimit të kredisë është 7275.15 dhe TVSH 1309.52€

Ndërsa për vitin 2021 sipas inspektorit 11940€ dhe TVSH 2149.20€ ku përfshihet edhe një pjesë e mjeteve të shitjeve Ditore. Sipas evidencës së planit të amortizimit 01/01/2021 deri me 31.12.2021 deponimet nga bankomatit për kredi janë 10474,18 dhe TVSH 1885.34 pjesa tjetër e deponimeve është e përfshirë edhe pazari ditor. Pra këto ish sugjerimet tona ndaj inspektorit dhe kontrollit është se tij .Sipas planit të amortizimit ku edhe është i bashkangjitur në dokumentacion. Sipas inspektorit çdo gjë me deponimet në bankomat është dyfishua gjë që është jonormale çka është bërë gjatë këtij kontrolli dhe pandemie -2019 Qarkullimi 108269.29 sipas pef 52556.37 -2020 Qarkullimi 54929.06 sipas pef 24498.30, 2021 Qarkullimi 67179.50 sipas pef 48286.15€, kërkojmë nga Divizioni i ankesave që duhet të behet të korrigjohen edhe njëherë Pasqyra e TVSH me 31.12.2019, dhe CD Vjetore 2019.Me office -exel andaj ajo vlerë është e përfshirë në pasqyrën e TVSH .Ndërsa inspektorit ma zbret prej TVSH. -Pasqyra e TVSH 03/2020 Te pasqyra e TVSH është e përfshirë vlera e faturës nr. 96/2020 Molika Gas me vlerë 2542.88 dhe

TVSH 457.72 ndërsa te libri i blerjes nuk ma ka barte exeli këto janë gabime teknike, prandaj ju lus që te mi pranoni këto deklarime se janë deklarua në rregull ne pasqyrat e TVSH.02/2020 dhe 03/2020, andaj duhet te ndryshohet edhe CD/2020. Inspektori te pika 5.4 Analiza e Llogarive bankare e ka përfshi datën gabimisht 17.01.2019 ajo duhet të jetë sipas planit te biznesit me 17.05.2019, gjë që e keni planin e amortizimit te kredisë per 50.000.00 euro nga BPB do te thotë se te gjitha vlerat e ratës se kredisë për çdo vit mi ka rrite. Gjithashtu te behet edhe amortizimi i mjeteve themelore sipas viteve 2019/2020/2021, dhe llogaritja e shpenzimeve reale ne paga per vitin 2019/2020/2021, per këtë ka qene ne dijeni edhe inspektori dhe i kemi ofrua dëshmi mirëpo ai nuk ka bashkëpunua fare me mua si kontabilist, per te gjitha këto parregullsi kemi dëshmi. Faturën e shpenzimeve te Stacionit ,Faturën e Molika Gas si dhe dëshminë e planit te amortizimit te kredisë Sipas opinionit që e kemi bërë inspektori nuk ka bërë asnjë ndryshim edhe pse dëshmitë ekzistojnë, dhe në fund të ankesës me shkrim tatimpaguesi potencon se pikat e lartcekura janë argumente të mjaftueshme që duhet marrë në konsideratë nga Departamenti i Ankesave.

Divizioni i Ankesave në bazë të nenit 95 të Ligjit Nr. 05/L – 031 Mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative ka organizuar seancën e dëgjimit më datë 23/09/2022, në të cilën të pranishëm ishin të gjitha palët e ftuara.

Tatimpaguesi në të drejtën e fjalës theksoj se ngarkesa është e dyfishtë, kontrolli ka përfunduar pa bashkëpunimin e kontabilistit, biznesi është ngarkuar me deponime nga banka, si dhe janë disa fatura të cilat i kanë paraqitur në deklaratën e periudhës 03/2020 të cilat nuk kanë qenë në libra të blerjes dhe exel nuk i ka bartur shënimet në librat elektronike në EDI deklarime, deponimet janë përmes ATM-së të cilat janë me përshkrime pagës per këste te kredisë, ditarin e arkës e kam mbajtur por shënimet me kanë humbur (për shkak se mu ka djeg llap topi) andaj kërkesa ime është të shqyrtohet bartja e mjeteve nga një bankë ne bankën tjetër. Në vitin 2019 biznesi ka marrë kredi në bankë për blerje të një autobusi dhe tërheqja e mjeteve është bere nga banka ProCredit Bankë dhe kredia është bartur ne banka tjera, po ashtu biznesi jone ka marrëveshje për bartjen e nxënësve të shkollave.

Inspektori i kontrollit në të drejtën e fjalës theksoj se kontrolli është hap nga analiza e riskut dhe në vitin 2019 kemi ndryshim prej 8000 nuk kemi tatim të dyfishtë njëjtë ka ndodhur edhe në vitet në vazhdim, rritja e qarkullimit është nga deponimet bankare, tatimpaguesi ka një kredi në vitin 2019 në vlerë prej 50,000.00€, lëshim teknik ka nga ana e tatimpaguesi ku nuk është përputhur libri i blerjes i deklaruar në Edi dhe libri fizik i tatimpaguesit por nga ne nuk ka lëshime teknike.

Pas dorëzimit të raportit të kontrollit është dorëzuar një faturë 96/2020 e cila ka qenë e deklaruar por jo edhe në libra andaj mbetet që Divizioni i Ankesave ta verifikojë këtë faturë, po ashtu tatimpaguesi pagën e pronarit dhe të Gruas se tij nuk e ka paraqitur në deklaratën vjetore. Deponimet janë pa përshkrim dhe me kontrolli kemi bërë krahasimin e deklarimeve dhe tërheqjeve me deponimet ku kemi bërë thyerjen e tyre diferencën e kemi trajtuar si qarkullim shtesë pasi që tatimpaguesi nuk ka mbajtur ditar arke.

Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit të ankesës dhe pas administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës, bëri ballafaqimin e tyre dhe vërtetoi se ankesa e subjektit në procedurë është pjesërisht e bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizionit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim:

Kontestin e tatimpaguesit për qarkullimin shtesë e cili ka rezultuar nga kontrolli sipas deponimeve bankare dhe atë për periudhën kontrolluese për vitin 2019-2021 me pretendimin e tatimpaguesit se një vlerësim i tillë është jo i drejtë, Divizioni i Ankesave pas analizimit të

dosjes vërtetohet se mbetet në fuqi vlerësimi i kontrollit sa i përket çështjes së trajtimit të deponimeve.

Divizioni i Ankesave konstaton se vlerësimi zyrtar nga ana e ATK-së është bërë mbështetur në nenin 19 paragrafi 2 të ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, dispozitë e cila parasheh që: Vlerësimi i Drejtorit të Përgjithshëm do të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjitha provat që ai ose ajo ka në dispozicion të cilat janë të listuar nga nën paragrafi 2.1 deri tek ai 2.6. Divizioni i Ankesave bazuar në dosjen që disponon për shqyrtimin e rastit konstaton se vlerësimi i kontrollit është bërë bazuar në provat e disponueshme materiale.

Divizioni i Ankesave sa i përket vlerësimit të inspektorit mbështetur në provat të cilat ka në dispozicion konstaton se kontrolli për vlerësim është bazuar në të hyrat/deponimet nga llogarit bankare të biznesit në Banken Pro Credit Bank, Banken Ekonomike dhe Banken Private të Biznesit dhe në këtë bankë biznesi ka marrë një kredi me datë 17.01.2019 në vlerë prej 50,000.00€ për blerje të autobusit andaj bazuar në dokumentacionin i cili është në dosje vërehet se tatimpaguesi pazarin ditor e ka deponuar në bankë vetëm si deponim dhe kontrolli me të drejtë e ka vlerësuar deponimet si të hyra të biznesit pasi që ka bërë thyerje mes deklarimeve dhe tërheqjeve ku pjesa e mbetur është trajtuar si e hyre e biznesi.

Kontestin e tatimpaguesit për trajtimin si të hyra nga ana e kontrollit, të deponimeve siç shifet në llogarit bankare dhe i cili trajtim sipas ankesës së tatimpaguesit nuk është i drejtë, Divizioni i Ankesave pas analizimit të dosjes së tatimpaguesit konstaton se mbetet në fuqi vlerësimi i kontrollit sa i përket deponimeve. Divizioni i Ankesave ka vërtetuar se kontrolli ka vlerësuar për lëvizjen e parasë duke marrë parasysh të gjitha tërheqjet/deklarimet në ATK dhe ka bërë thyerjen me deponimet, andaj në mungesë të vërtetimit të prejardhjes së tyre nga tatimpaguesi këto deponime janë trajtuar si e hyre bazuar në nenin 30 i Udhëzimit administrativ 15/2010 thotë:

3.2. Metoda e Depozitave Bankare dhe Shpenzimeve të Kesh-it (në vijim MDBShK).MDBShK, llogarit të ardhurat duke treguar çfarë ka ndodhë me fondet e tatimpaguesit. Është e bazuar në teorinë që nëse një tatimpagues merr para, mund të ndodhin vetëm dy gjëra: ato ose mund të depozitohen ose mund të shpenzohen, në këtë rast tatimpaguesi i ka deponuar pazarin ditor si deponime.

Kontesti i dytë i tatimpaguesi lidhur me deklaratën e TVSH-së 03/2020 sipas kontrollit nuk është e përfshirë vlera e faturës nr. 96/2020 Molika Gas me vlere 2542.88 dhe TVSH 457.72 totali i faturës 3000.60€, ndërsa të libri i blerjes nuk e ka barte exeli këto janë gabime teknike, Divizioni i Ankesave lidhur me këtë lëshim apo gabim teknik ku kontrolli nuk ja ka pranuar faturën e blerjes me nr. 96/2020 me datë 31.03.2020 fatura e lëshuar nga biznesi Molika Gas, në kemi kërkuar informata shitesë nga tatimpaguesi duke i kërkuar që të na sjell të gjithë kuponët fiskal të cilët janë të përfshirë në faturë. Divizioni i Ankesave vlerëson se fatura nr. 96/2020 e lëshuar nga biznesi Molika Gas është faturë e rregullt dhe e cila i plotëson kriteret për tu pranuar si blerje në deklaratën e TVSH 03/2020 si dhe si shpenzim në deklaratën vjetore CD/2020 këtë pranim të faturës e mbështesim në nenin 20 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 pasi që kjo faturë është lëshuar në bazë të kuponëve fiskale dhe përmban numrat serik të kuponëve fiskale siç parashihet me legjislacionin tatimor përkatësisht me Udhëzimin Administrativ 15/2010 Neni 20 paragrafi 4 i cili parasheh: *Kuponi i regjistruarit të kesh-it. Secili person i angazhuar në shitje me pakicë duhet ta fusë atë transaksion në një regjistruar fiskal të keshit, apo pajisje tjetër të aplikueshme sikurse është përshkruar në këtë Udhëzimin Administrativ, që lidhet me regjistruarit fiskal të keshit apo pajisjet elektronike fiskale. Duke pasur parasysh kërkesat për të dokumentuar origjinën e mallrave, një person që kryen blerje në shitjen me pakicë duhet të posedojë një kupon të regjistruarit të keshit që do të ofrojë evidencë dokumentuese për origjinën e mallrave në posedim. Megjithatë, për një blerje me pakicë për të kërkuar si shpenzim në një Deklaratë të Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (në vijim TAK) apo Deklaratë të Tatimit në të Ardhurat Personale (në vijim TAP), një kupon i regjistruarit të keshit duhet të shoqërohet me një faturë sikurse është përshkruar në paragrafin 1, 2 apo 3 të këtij Neni, varësisht nga statusi i shitësit dhe blerësit. Një kupon i*

lëshuar nga një regjistruer i keshit duhet të përmbajë së paku elementet vijuese (specifikacionet teknike pasuese për arkat fiskale dhe pajisjet elektronike fiskale mund të kërkojnë elemente tjera shtesë në një format të veçantë, në të cilin rast një kupon i regjistruerit të keshit duhet të plotësojë ato elemente shtesë për të shmangur ndëshkimet) në këtë rast tatimpaguesi është furnizuar me derivate gjatë tërë muajit me kuponë fiskal dhe në fund të muajit ka marrë një faturë tatimore ku janë përfshirë të gjithë kuponët fiskal në faturë po ashtu është përfshirë edhe njësia, sasia dhe çmimi, andaj si rezultat i pranimit të kësaj fature kemi ndryshim në deklaratën e TVSH periudha 03/2020 tek kolona 43 blerjet vendore me normë 18% të TVSH-se ku vlera e faturës së tatueshme është 2542.88€ TVSH-ja 457.72€, sipas Divizionit të ankesave rezulton se kemi ulje të TVSH-së për pagës në vlerë prej 457.72€ (pa interes dhe ndëshkime) si dhe uljen e tatimit në fitim në vlerë prej 254.20€ në deklaratën vjetore CD/2020 me rastin e pranimit si shpenzim faturën në vlerë prej 2542.88€.

Divizioni i Ankesave vlerëson se pikat tjera kontestuese mbesin sipas kontrollit pasi që tatimpaguesi nuk ka ofruar fakte dhe dëshmi që e dëshmon të kundërtën e asaj që ka vlerësuar kontrolli.

Nga arsyet e theksuar më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222, "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", dhe nenin 132/2 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në Nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat" 03/L - 222, tatimpaguesi i pakënaqur ka të drejtë që brenda afatit (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë Vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr. 388/2022 datë 02/11/2022

Vendimi t'iu dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi _____

Kryesues i panelit shqyrtues
Bashkim Paçarizi _____

